

**Ismail Kadare:**

**Enver Hoxha është si një mal i madh. Sa më nga larg ta shohësh, aq më i madh duket!**



**Pelo Pelivani:** T'ungjatë jeta zoti Kadare, dhe të lulëzoftë pena!

**Kadare:** Eh, more Pelo, iku vapa me gushtin. Lulëzonte kur lulëzonte pena. Dua të them se lulëzonte në një sistem kur nuk kishte lule, ndaj dhe lulet e mija binin aq shumë në sy.

**Pelo Pelivani:** Ka mundësi që ta kini fjalën për sistemin e Diktaturës së Proletariatit besoj...

**Kadare:** Shumë mirë bën që beson ti, Pelo, por fatkeqësisht ai sistem i mallkuar nuk qe sistemi i Diktaturës së Proletariatit por, Sistemi i Diktaturës së Diktatorit.

**Pelo Pelivani:** Ka mundësi që ta kini fjalën për shokun Enver Hoxha, besoj...

**Kadare:** Natyrisht, Pelo, që për Atë e kam fjalën, e s'mund ta kem për askënd tjetër se një sistem që ndërtohet mbi Dhunën dhe Diktatin nuk mund të ketë kurrë dy Diktatorë, por Një dhe vetëm Një!.

**Pelo Pelivani:** Besoj se ky Diktatori me emrin Enver Hoxha, që ka qënë Një dhe vetëm Një, nuk duhet të ketë ndonjë lidhje direkte me personazhin kryesor të romanit të famshëm " Dimri i Vetmisë së Madhe", që më pas u redaktua pak e u bë " Dimri i Madh". Jam i bindur se ky Enveri i "Dimrit të Madh" nuk mund të jetë Diktatori , mbasi aty Ai paraqitet si një Perëndi, bile Perëndia më e madhe dhe më e drejtë e Universit...

**Kadare:** Epo, këtu gabon ti, Pelo! Diktatorët si gjithnjë janë për një popull, dhe ashtu duhet të paraqiten. Pra, me pak fjalë Diktatori i Diktaturës së Proletariatit, Enver Hoxha është i njëjtë me Enver Hoxhën e " Dimrit të Madh", domethënë nuk bëhet fjalë për lidhje direkte, apo indirekte, por janë i njëjti individ i patjetërsueshëm siç jemi unë e ti...Po unë atë libër e kam bërë me hile, o Pelo! Me atë libër kisha qëllim të rrëzoja Diktatorin se unë me penë punoja dhe jo me bomba e granata. Nejsë "Dimri i Madh" ishte si një Bombë Atomike që do të hidhte në erë Diktaturën...

**Pelo Pelivani:** Edhe kopil dhe bir kopili të jem nuk e përqas dot Bombën Atomike me “Dimrin e Madh” dhe aq më shumë nuk shoh ndonjë hile aty...

**Kadare:** Po hilet nuk duken e nuk kuptohen o, Pelo, ndaj dhe quhen hile...Por po të ta shpjegoj unë fare-fare pak do të bindesh menjëherë e do më ngrësh kapelen..

**Pelo Pelivani:** Jam shumë kurioz t’ju dëgjoj dhe ju siguroj se kam predispozicion për t’u bindur nga ato që do të dëgjoj...

**Kadare:** E di ti Pelo nga e hëngri Stalini?

**Pelo Pelivani:** Natyrisht, që e di. Stalini e hëngri nga Perëndia në moshën 17 vjeçare...

**Kadare:** Futja kot tani...Perëndia është njëra anë, por Ai e hëngri nga ngritja në zenith e Kultit të Individit...

**Pelo Pelivani:** Këtë e di shumë mirë, por problemet e Kultit të individit dhe trimëria e kundërshtarëve të tij u shfaqën mbas vdekjes së Stalinit, ndërsa...

**Kadare:** Këtu gabon ti, Pelo dhe jo vetëm ti. Diktatorët e vdekur janë më të fuqishëm dhe më të rrezikshëm se Diktatorët e gjallë, mbasi mbeten në memorien popullore si një Institucion i Shenjtë Fetar, për të cilin janë gati të bëhen kamikazë miliona individë...Pra, kur shkrova “Dimrin e Madh” synimi im kryesor ishte që të ngrija Kultin e Enver Hoxhës gjer në qiell dhe udhëheqësit e tjerë t’i paraqisja si lilliputë të mjerë para një Gjigandi. Historian...

**Pelo Pelivani:** Dhe, ju do të rebelonit këta lilliputë të mjerë kundër Gjigandit të Historisë?!...Shumë interesante kjo. As ty vet nuk do të kishte shkuar mëndja në atë kohë. Por megjithatë nuk funksionoi...

**Kadare:** Funksionoi Pelo, por me pak vonesë. Funksionoi në 20 shkurt të vitit 1991. Pa “Dimrin e Madh” me Kultin e Diktatorit nuk mund të rrëzoheshin kurrë bustet dhe monumentet e Enver Hoxhës. Këto ngjarje i kisha para përgatitur unë por fatkeqësisht atë ditë të lume nuk ndodhesha në vend- fortesën, se isha me shërbim jashtë shtetit. Por kjo qe lufta ime, beteja ime, fitorja ime.

**Pelo Pelivani:** Faleminderit, dhe të uroj nga zemra të tjera fitore të tilla, duke shkruar fjala vjen romanin: “Ditët e beharit të madh”, me personazh kryesor Sali Berishën, vetëm se Saliu nuk ka akoma monumente. Nejse, bëje ti romanin, pastaj dimë ne se ç’bëjmë!

**Kadare:** Dhe juve faleminderit, e mirë u takofshim në ndonjë vend-festë.

**Bisedoi miqësisht Pelo Pelivani, d.v.**